

VENDIM
Nr. 60, datë 3.6.2013

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES TIP TË TRANSMETIMIT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE MIDIS OST SHA DHE FURNIZUESVE TË KUALIFIKUAR**

Në mbështetje të nenit 9 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, pikës “V” të Rregullave të Tregut Shqiptar të Energjisë, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 68, datë 23.6.2008, pikës 4.13 germa “A” pika 3, pikës 7 germa “g” të Modelit të Tregut të Energjisë Elektrike miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 338, datë 19.3.2008, të ndryshuar, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 3.6.2013, pasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga drejtoritë teknike të ERE-s dhe marrëveshjen tip të transmetimit të energjisë elektrike, midis OST sh.a. dhe furnizuesve të kualifikuar,

konstatoi se:

- Subjektet e kësaj kontrate, OST sh.a. dhe çdo furnizues i kualifikuar, janë subjekte të licencuara nga ERE;

- Dispozitat e kësaj kontrate janë në harmoni me ligjin nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, Modelin e Tregut të Energjisë miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 338 datë 19.3.2008, Rregullat e Tregut të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 68, datë 23.6.2008, të ndryshuar;

- Modeli i tregut vendos ERE-n në cilësinë e autoritetit që ka të drejtën për të miratuar këtë natyrë kontrate.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve

VENDOSI:

1. Miratimin e draft marrëveshjes tip për shërbimin e transmetimin midis OST dhe furnizuesve të kualifikuar.

2. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për njoftimin e palëve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani